




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prištine - Municipality of Prishtina

DREJTORIA E FINANCA

Zyra për buxhet dhe financa

Plani i punës i vitit 2018

Dhjetor, 2017

Drejtoresë e Drejtorisë, Valbona Makolli
Udhëheqës i Sektorit për buxhet e financa, Eroll Raskova

Faqe 1 nga 8

Përmbajtja

Hyrje.....

Objektivat

Analiza

Monitorimi dhe raportimi.....

HYRJE

Në mbështetje të Kapitullit IV, neni 65, pika 1, Kapitulli IX, neni 120, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të përmirësimit të shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësive buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar për autoritetet publike dhe ndërmarrjet publike në Kosovë, si dhe për përshkrimin e kompetencave dhe detyrave të ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe autoriteteve të tjera publike rreth këtyre çështjeve, duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-048, mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, si dhe Rregulloren nr. 01/2013/MF – Shpenzimet e parave publike, është krijuar bazën juridike që Komuna e Prishtinës ta ushtrojë veprimtarinë e vjeljes:

- a) taksa, tarifa, detyrime ose tarifa për shfrytëzim;
- b) interesa, dividendë ose pagesa të tjera;
- c) të ardhurat nga shitja, qiradhënia ose qiramarrja e çfarëdo prone;
- d) tarifat rregulluese, tarifatat e licencimit, si dhe tarifatat dhe taksat e ngjashme;
- e) pagesat, tarifatat dhe taksat për ofrimin e shërbimeve, furnizimin e mallrave ose kryerjen e punëve;
- f) të ardhurat e pranuar, ose të cilat janë realizuar drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë nga dhënia e lejeve ose nga shitja e cilësdo të drejtë mbi një burim publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar në të drejtën ndaj brezit frekuencor, të drejtën e shfrytëzimit të tokës, të drejtat për eksplorimin ose eksploatimin e pasurive natyrore ose të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat mbi pronën intelektuale;
- g) rentat;
- h) depozitat e sigurimit dhe të kushtëzimit;
- i) gjobat, kompensimet e dëmit nga paditë civile dhe të ardhurat nga sigurimi;
- j) granatet dhe donacionet nga organizatat ndërkombëtare, qeveritë e huaja ose cildo burim tjetër, arkëtohen në llogarinë e Komunës dhe përdoren nga Komuna, në përputhje me Ligjin nr. 03/L-048, për financat publike dhe përgjegjësitë.

Për të siguruar një punë efikase, Zyra për buxhet dhe financa përgatit Planin e punës për vitin 2018, në të cilin plan do të paraqiten objektivat dhe dinamika e arritjes së këtyre objektivave për këtë vit.

Qëllimi i këtij plani është të përgatisim një plan të menaxhimit, të bazuar në kapacitete subjektive dhe teknike, të bazuar në performancën e deritashme dhe shfrytëzimit më të mirë të kapaciteteve që i ka kjo drejtori, si dhe mundësitë e përmirësimit përforcues dhe kushteve të punës si domosdoshmëri e rritjes së rezultateve të punës.

Realizimet e objektivave gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017 janë realizuar objektivat e punës:

Buxheti fillestar për vitin 2017 :	70,770,220.03 €
Buxheti i shpenzuar për vitin 2017:	57,050,653.39 €
E shprehur në përqindje:	80.03 %

Rëndësia dhe hapat

Rëndësia e këtij plani mundëson eliminimin e dobësive që na kanë përcjellë nga viti paraprak, e që kanë ndikuar direkt në performancë. Menaxhimi i bazuar në performancë, është një qasje që në mënyrë sistematike mundëson përmirësimin e performancës përmes një procesi të vazhdueshëm të vendosjes së objektivave, matjes së performancës përmes grumbullimit, analizimit dhe rishikimit të të dhënave. Duke i pasur parasysh këto të dhëna, arrijmë në përfundim se kemi rritje të performancës.

Rëndësia e menaxhimit duhet të bazohet në performancë e jo në numër të aktiviteteve, sepse rezultate janë ato që flasin.

Duke u bazuar në rezultatet e arritura gjatë vitit 2017, na mundësojnë një komoditet për vazhdimin e suksesit edhe për vitin 2018.

Problemet nga viti paraprak

Ka pasur pengesa në menaxhimin e sistemit për të dhënat e tatimpagueseve, ngase në Ministri janë bërë reforma më të avancuara. Gjatë për zbatimin e këtij sistemi kemi pasur edhe mospërputhje të të dhënave të tatimpaguesve, kështu që në mënyrë manuale jemi detyruar t'i korrigjojmë këto gabime. Ka pasur probleme në bartjen e pagesave dhe ndryshime në kartelën financiare. Një ndryshim që vlen për t'u theksuar, është shlyerja e borxhit nga vitet paraprake, ku te palët ka shkaktuar pakënaqësi, ngase palët të cilët kanë lidhur kontrata për amnisti, kur kanë kryer pagesën e viteve të fundit, pagesa i ka kaluar te pagesa e kontratës.

Trajnimet për staf janë të domosdoshme në ripërtëritjen e informatave, programeve në avancim të stafit tonë.

Koordinimi me drejtoritë e tjerë për sigurime të informacioneve janë të domosdoshme, sidomos me menaxherët dhe mbikëqyrësit e projekteve se deri ku ka arritur realizimi i punimeve, e që barazimi në fund të vitit është i domosdoshëm për drejtorin tonë, që në bazë të raporteve të përbashkëta ofrojmë të dhënat për bartjen e mjeteve nga vitet e mëhershme në vitin 2018.

OBJEKTIVAT 2018

Lidhur me objektivat që lidhen me punën komfor udhëzimit administrativ UA (QRK)-03/2015.

Për vitin 2018, kemi si synim që të rrisim buxhetin e shpenzuar. Të punojmë më shumë me drejtoritë tjera që të mos ketë vonesa të lëndëve që kontrollohen dhe paguhen nga ana jonë.

Burimet e financimit për Komunën e Prishtinës janë grand i përgjithshëm, grand i specifik për arsim, grand i specifik për shëndetësi, si dhe të hyrat vetjake të Komunës.

Për të arritur objektivat kërkohet mobilizim i të gjithë kapaciteteve që ka sektori ynë, duke angazhuar në punën e përditshme sipas këtij plani dhe duke kërkuar raportime të përditshme për punën e kryer të secilit punëtor brenda sektorit dhe jashtë sektorit tonë.

Të kemi një bashkëpunim më të devotshëm me drejtoritë e tjera në zbatimin e linjave buxhetore.

Për realizimin e objektivave është e domosdoshme që të futen edhe kushtëzimet për kryerjen e punëve edhe nga drejtoritë e tjera të Komunës së Prishtinës.

ANALIZA E OBJEKTIVAVE

Përparësitë

Nga përparësitë që mundësojnë realizimin e këtij plani është edhe gatishmëria politike, që nënkupton mbështetjen e Kryetarit, drejtorit në plotësimin e kushteve të punës për stafin i cili do të bëjë zbatimin e këtij plani. Kushtet e punës ndikojnë direkt në realizimin e objektivave që janë: stafi i kompletuar, i kualifikuar dhe trajnuar për punët me të cilët ngarkohet, motivimi i stafit, plotësimi i kushteve të punës, caktimi i normës së punës dhe notimi i stafit në bazë të performancës së treguar gjatë punës.

Dobësitë

Dobësitë në mosparaqitjen e raporteve në rregull kanë të bëjë edhe me tatimin në pronë. Kjo drejtori ka disa probleme, të cilat duhet të eliminohen, regjistrimet e dyfishta, të cilat kanë ardhur si pasojë e regjistrimit të më hershëm të shfrytëzuesve (uzurpatoreve), dhe pastaj është bërë regjistrimi i pronarëve dhe kështu janë krijuar fatura të dyfishta. Këto fatura janë fatura fiktive dhe kërkojnë një angazhim në identifikim e tyre. Mos identifikimi i këtyre faturave figurojnë si borxhe, të cilën Komuna nuk mund ta inkasojë dhe këto borxhe vetëm rriten, çka ndikon direkt në performancë negative, si dhe llogaritë e arkëtuara janë të fryra për shkak të këtyre problemeve.

Mundësitë

Mundësia e realizimit të ndonjë donacioni nga organizatat e ndryshme që mbështesin punën e komunave me projekte konkrete, të cilat duhet të arsyetohen në mënyre profesionale. Gatishmëria e këtyre institucioneve në mbështetje të drejtpërdrejtë në organizimin e seminareve, që mundësojnë krijimin e përvojave për punë më efikase dhe ide të reja të punës.

AKTIVITETET

1. Aktiviteti – Analiza e llogarive të arkëtuara

Analiza e llogarive të arkëtuara

Në këtë pjesë kemi probleme të paraqitjes së shumave reale të llogarive të arkëtuara. Të punohet në përmirësimin e të dhënave dhe në paraqitjen reale të llogarive të arkëtuara.

2. Aktiviteti, shpërndarja e punës në mes të stafit

Në fillim të vitit kemi më shumë punë rreth raportimeve të ndryshme dhe nevojitet angazhim më i madhe i stafit, në përmbledhjen e shënimeve për përpilimin e raporteve të pasqyrave financiare, Raportin për Kuvend, Raportin buxhetor për vitin 2018 etj.

3. Aktiviteti, takime me udhëheqës të shkollave, kopshtet e fëmijëve e për barazime.

Të gjitha shkollat dhe kopshtet e fëmijëve të komunës së Prishtinës, çdo muaj bëjnë barazime e të hyrave që i kanë me zyrtarin e të hyrave. Bëjnë përmirësimin e gabimeve, mbledhjen e të dhënave, këshillime etj.

Kemi edhe persona fizikë që kanë probleme në mosfigurimin e pagesave, për të cilat u jepet dëshmi nga raporti bankar nëse kanë paguar dhe nuk figuron në gjendjen e tyre të tatimit në pronë, kemi kthimin e mjeteve, përcjelljen e sigurimeve për dhënien e lejeve ndërtimore etj.

4. Aktiviteti, raportimi i obligimeve

Çdo muaj bëjmë raportim në Ministrinë e Financave për obligimet e mbetura pa paguar. Raporti bëhet në bazë të faturave që i kemi pranuar nga të gjitha drejtoritë dhe nga palët të cilët i kanë dorëzuar në sportele, kompletohet raporti dhe dorëzohen në Ministrinë e Financave.

4. Aktiviteti, regjistrimi i pasurive

Regjistrimi i pasurisë bëhet gjatë tërë vitit, varësisht nga pagesat që bëhen. Regjistrimet bëhen në SIMFK dhe në Excel, të krijuar nga stafi për nevojë të stafit dhe raportim sa më të lehtë.

4. Aktiviteti, arkivimi dhe regjistrimi i pagesave

Regjistrimi i të gjitha pagesave bëhet gjatë tërë vitit, varësisht nga pagesat që bëhen. Regjistrimet bëhen në Excel, të krijuar nga stafi për nevojë të stafit dhe raportim sa më të lehtë.

4. Aktiviteti, menaxhimi dhe raportimi i buxhetit

Drejtoria jonë bën një menaxhim të mirë sa i përket përcjelljes së linjave buxhetore për shpenzimet e bëra, raportimet janë në nivelin e duhur dhe në kohë të caktuar:

- Përgatitja e rrjedhës së parasë të vitit 2018 – Kesh plani;
- Alokimi i të hyrave vetanake sipas kërkesave nga sektorët;
- Përgatitja e bartjes së mjeteve nga viti 2017 në vitin 2018;
- Raportimet e buxhetit bëhen çdo muaj gjatë tërë vitit;
- Raportimet për Kuvend çdo tremujor;
- Raportimi i progresit të kapitaleve sipas kvartaleve në MF;
- Raportimi i faturave të papaguara mbi 30 ditë në MF;
- Barazimi me MF-në për të hyrat dhe të dalat sipas kvartaleve;
- Pranimi i qarkoreve buxhetore për vitet 2019-2021;
- Përgatitja e rishikimit buxhetor, nëse ka për vitin aktual;
- Përgatitja e Buxhetit për vitet 2019-2021;
- Futja e të dhënave buxhetore në sistemin PIP dhe BDMS për vitet 2019-2021;
- Pasqyrat financiare nëntëmujore;
- Pasqyrat financiare vjetore;
- Pasqyrat financiare vjetore korrigjuese;
- Auditimi nga ZAP për të hyrat dhe të dalat për periudhën nëntëmujore;
- Auditimi nga ZAP për të hyrat dhe të dalat për periudhën vjetore.

MONITORIMET DHE RAPORTIMET

- *Kryetari i Komunës, mbështetje në realizimin e objektivave*

Kryetari i Komunës duke shfrytëzuar kompetencat, mbështet drejtorinë, duke i mundësuar drejtorisë që të ketë në dispozicion akomodim të mjaftueshmen në zyra të nevojshme dhe t'i mbështet iniciativat që mendon se janë të qëlluara dhe ndikojnë direkt në përmbushjen e objektivave.

- *Drejtori i Financave, mbështetje për realizimin e objektivave, ndihmon në plotësimin e kushteve të punës, kërkon performancë të mirë në realizimin e objektivave.*